



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
Januar 06/07/2022			
Nj. Org	Numër	Shërbimi	Vlera
01	900/01-	33921	



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna Drenas
Opština Drenas – Municipality of Drenas**

Datë: 06.07.2022

Kryetari i Komunës në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, me 28/04, qershor 2008), nenit 24 të Rregullores (QRK) - Nr. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme dhe nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nxjerr:

V E N D I M

I. Për themelimin e Komisionit Komunal për Kthim.

II. Komisioni Komunal për Kthim përbëhet nga 8 anëtarë të institucioneve si në vijim:

- | | |
|-------------------------|-----------------------------------|
| 1. Afije Veseli-Berisha | ZKKK-ja; kryesues |
| 2. Hazir Elshani | Arsimi; |
| 3. Albulena Lushtaku | Shëndetësia; |
| 4. Vlorjan Meha | Puna dhe mirëqenia sociale; |
| 5. Antigona Durmishi | Shërbimet publike; |
| 6. Besart Bajrami | Planifikimi dhe urbanizmi; |
| 7. Defrim Nika | Gjeodezisë, kadastrës dhe pronës; |
| 8. Miodrag Djekic | Përfaqësuesit e MKK-së. |

III. Tek projektet bilaterale çështja e pjesëmarrjes dhe roli i përfaqësuesit në Komisionin Komunal për Kthim nga radhët e donatorit rregullohet me marrëveshje në mes MKK-së, Komunës dhe donatorit.

IV. UNHCR-ja ka rolin këshillues në Komisionin Komunal për Kthim.

V. Komisioni komunal për kthim duhet të reflektoj përbërje etnike dhe gjinore, si dhe do të jetë i hapur për organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare për qëllim të monitorimit.

VI. Komisioni komunal për kthim, është organ rekomandues, i cili propozon rastet për vendim tek Komisioni Qendror Shqyrtues në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim.

VII. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.



Kryetari i Komunës

Hamiz Lladrovci

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Personelit;
- Anëtarëve të komisionit;
- Arkivit të Komunës së Drenasit;